



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2018

**V E N D I M**

**Nr. 91 , Datë 05 / 04 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.52 Regj., datë 03.08.2017, e z.S. M, kundër Ujësjetllës-Kanalizime sh.a Fier, me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Z.M në ankesën e tij shprehet se, që prej muajit Maj të vitit 2017, i është ndërprerë furnizimi me ujë të pijshëm në banesë. Ai citon se i ka paguar rregullisht faturat e ujit dhe nuk e di arsyen se përse i është ndërprerë furnizimi me ujë të pijshëm vetëm familjes së tij, ndërkohë që familjet e tjera (jo romë) që jetojnë në të njëjtin pallat (lagje) kanë ujë të pijshëm.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të tij për shkak të racës nga ana e Ujësjetllës-Kanalizime sh.a Fier.

**II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, **racën**, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike,

---

<sup>1</sup> Ankuesi i përket komunitetit rom. Ankesa është marrë në kuadër të “Ditëve të hapura”, organizuar me komunitetin rom në qytetin e Fierit.

*gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.754/1 prot, datë 10.08.2017 të Komisionerit i është kërkuar informacion Ujësjellës-Kanalizime sh.a Fier/Bashkia Fier, lidhur me pretendimin e z.M.

Megjithë tejkalimin e afateve të parashikuara në ligj për kthimin përgjigje, ky institucion nuk solli asnjë përgjigje shkresore.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 02.11.2017<sup>3</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë ambjenteve të Ujësjellës-Kanalizime sh.a Fier.

Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me Shefin e Zyrës së Shitjeve, z.E. Gj, me të cilin u mbajt një procesverbal ku u reflektua fakti që dokumentacioni i kërkuar në Urdhërin e inspektimit do të dërgohej shkresërisht, me shërbim postar. Kjo për shkak se dokumentacioni i kërkuar nuk disponohej momentalisht nga ana e këtij institucioni<sup>4</sup>.

---

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

<sup>3</sup> Në zbatim të Urdhërit nr.128, datë 06.10.2017, të Komisionerit.

<sup>4</sup> Megjithëse ata ishin njohur me kërkesat e Urdhërit të Inspektimit të Komisionerit, që me datë 09.10.2017, datë në të cilën kanë marrë dijeni, referuar lajmërim marrje poste me bar kod: RR 090 128 100 AA.

3. Me shkresën me nr.716/1 prot., datë 09.11.2017 Ujësjetllës-Kanalizime sh.a Fier kanë informuar Komisionerin se: *“Në kuadër të mbledhjes së detyrimeve që kanë abonentët debitorë ndaj ndërmarrjes, Ujësjetllës-Kanalizime sh.a Fier ndjek procedurën përkatëse për të gjithë abonentët debitorë. Në bazë të të dhënave të dala nga sistemi i operimit Al-Billing, të cilat dalin automatikisht, procedohet deri në ndërprerjen e furnizimit me ujë, pa bërë diferencim ndërmjet abonentëve. Në zonën e Levanit është ndjekur e njëjta procedurë si për të gjithë abonentët debitorë ndaj Ujësjetllës-Kanalizime sh.a Fier. Abonenti me nr.kontrate 2400420 (z.M) rezulton debitor në vlerën 83.281 lekë, gjë për të cilën është njoftuar vazhdimisht”*.

Bashkëngjitur shkresës, Ujësjetllës-Kanalizime sh.a Fier ka dërguar një kopje të pasqyrës analitike të historikut të faturimit të pagesave të kryera, si dhe vlerës së detyrimit të ankuesit.

4. Me vendimin nr.52, datë 07.02.2018 Komisioneri ka gjobitur UK Fier për mos dhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar lidhur me ankesën e z.M<sup>5</sup>.

Me shkresën me nr.180 prot., datë 14.02.2018 UK Fier ka sjellë dokumnetacionin e kërkuar nga Komisioneri.

5. Me vendimin nr.72, datë 19.03.2018, Komisioneri ka shfuqizuar vendimin nr.52, datë 07.02.2018 të tij, pasi UK Fier ka përmbushur pikën 4 të këtij vendimi duke zbatuar rekomandimin e Komisionerit lidhur me vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

### **III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:**

- **Lidhur me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar nga Ujësjetllës-Kanalizime sh.a Fier, për shkak të racës së tij.**

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

---

<sup>5</sup> Duke cituar në pikën 3, të këtij vendimi se: “Zbatimi i vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijeni për sanksionin, sjell shfuqizimin e tij”.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Nga shqyrtimi i praktikës së ndjekur nga UK Fier, rezulton se bazuar në Urdhërin e Punës nr.973 prot./2017 të UK Fier, janë ngarkuar disa grupe pune për kryerjen e ndërprerjes së furnizimit me ujë të abonentëve debitorë. Referuar procesverbalëve të mbajtura nga grupet e punës në terren të UK Fier, në zona/lagje të ndryshme të qytetit Fier, rezulton se u është ndërprerë furnizimi me ujë të gjithë abonentëve që rezultojnë debitorë, përfshirë edhe z.M<sup>6</sup>. Pra, ndërprerëja e furnizimit me ujë nga ana e UK Fier ka ardhur si rezultat i mospagesës nga ana e abonentit dhe jo për shkak të racës së tij.

Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk është trajtuar ndryshe, në mënyrë të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e UK Fier për shkak të racës së tij, por njëlloj si të gjithë abonentët debitorë. (duke e krahasuar me abonentët të cilët nuk i përkasin komunitetit rom/egjiptian).

Nga ana tjetër, subjekti ankues nuk ka paraqitur asnjë dokument ku të provojë se ka realizuar pagesën e ujit të konsumuar dhe se atij i është ndërprerë furnizimi me ujë në mënyrë të padrejtë. Shlyerja e detyrimeve kontraktore ndaj UK Fier është detyrim ligjor për të gjithë abonentët pa dallim race e përkatësie.

Në përfundim, Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me veprim ose mosveprim nga ana e UK Fier, që të krijojë baza për mohimin e barazisë ose që ekspozon ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë jo romë. Nuk rezulton të ketë trajtim të pafavorshëm apo diskriminues të z.M, për shkak të racës së tij.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

---

<sup>6</sup> Kështu, në Rajonin nr.1 u është ndërprerë furnizimi me ujë 12 abonentëve që figuronin debitorë<sup>6</sup>. Në Rajonin nr.2 u është ndërprerë furnizimi me ujë 5 abonentëve që figuronin debitorë. Në Rajonin nr.3 u është ndërprerë furnizimi me ujë 5 abonentëve që figuronin debitorë. Në Rajonin nr.4 u është ndërprerë furnizimi me ujë 15 abonentëve që figuronin debitorë, etj.

## **VENDOSI:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z.S. M, nga ana e Ujësjellës Kanalizime Fier, për shkak të racës së tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: raca)

(fusha: të mira dhe shërbime)